REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 819/20
Datë/Datum. 10.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi ***Dior Halili***	***Data e autorizimit të ekspertit*** ***23/10/2020***	*Data e dorëzimit të raportit* ***28/10/2020***

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 19.10.2020, OE "EdiBau-ing SHPK" – Prizren, ka parashtruar ankesë me nr: 819/20 kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit numër **"622-20-2647-5-2-1"**, respektivisht atij me titull **"Ndërtimi i objektit të ri shkollor Zef Lush Marku në Velezhë faza e tretë"**, iniciuar nga AK – KK Prizren.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, ndarja në pjesë: jo, vlera e parashikuar e kontratës: 250,000.00€.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim.

Njoftimi për kontratë: 08.06.2020
Hapja e ofertave: 02.07.2020
Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 20.07.2020
Kërkesa për rishqyrtim: 21.07.2020
Vendimi i AK-së për refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim: 28.07.2020
Vendimi i panelit shqyrtues të OSHP-së për ankesën me numër rendor 548/20: 17.09.2020
Letra standarde për tenderuesit e eliminuar me datë: 30.09.2020
Kërkesa për rishqyrtim nga OE ankues me datë 05.10.2020
Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim me datë: 08.10.2020

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2.PRETENDIMET ANKIMORE

Me datën: 19.10.2020, OE "EdiBau-ing SHPK" – Prizren, ka parashtruar ankesë me nr: 819/20 kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit numër **"622-20-2647-5-2-1"**, respektivisht atij me titull **"Ndërtimi i objektit të ri shkollor Zef Lush Marku në Velezhë faza e tretë"**, iniciuar nga AK – KK Prizren.

OE ankues ka pretenduar që janë shkelur këto dispozita ligjore:

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 27,28 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 52 i LPP-së
Neni 108A i LPP-së

Kundër vendimit të autoritetit kontraktues Komuna e Prizrenit,mbi dhënien e kontratës dhe letrës standarde për eliminim gjatë fazës së ri-vlerësimit,kemi parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim për aktivitetin e prokurimit:"Ndërtimi i objektit të ri shkollor Zef Lush Marku në Velezhë faza e tretë",numri i aktivitetit të prokurimit: 622-20-2647-521.
Autoritei kontraktues në vendimin e saj të dt.08.10.2020 e refuzon kërkesën tonë për rishqyrtim dhe fare nuk jep përgjigje lidhur me pretendimet tona të parshtrara në kërkesën për ri-shqyrtim por vetëm me një paragraf ***"Lënda në fjalë ka qen objekt shqyrtimi në OSHP dhe vendimin e këtij organi , e ka zbatu Autoriteti Kontraktues duke iu shpallur juve të papërgjegjshëm".***
Ashtuqë në pajtim me nenin 109 të LPP parashtrojm ankesë kundër vendimit të AK me të cilin e refuzon kërkesën tonë për ri-shqyrtim,duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 108A sepse i njejti fare nuk ka trajtuar kërkesën tonë dhe nuk ka dhënë arsyeshmëri për secilin pretendim ankimor.

Bazuar në vendimin e AK-Komuna e Prizrenit të dt.08.10.2020 me të cilin refuzon kërkesën tonë për ri-shqyrtim me arsyetimin se "Lënda në fjalë ka qen objekt shqyrtimi në OSHP dhe vendimin e këtij organi , e ka zbatu Autoriteti Kontraktues duke iu shpallur juve të papërgjegjshëm",gjejmë se AK me rastin e ri-shqyrtimit fare nuk është marr me kërkesën tonë për ri-shqyrtim,por e njejta vetëm ka zbatuar vendimin e OSHP pa u lëshuar në shqyrtim të qështjes dhe për të dhënë arsye të sakt dhe profesionale për secilin pretendim ankimor,nga vendimi i tyre nuk gjejm se ka ndonjë arsye profesionale dhe të

mbështetur në dispozitat e LPP-ës.
Bazuar në dispozitat e nenit 116.6 të LPP-ës nuk nënkupton që me rastin e ri-vlerësimit të mos rekomandohet i njejti OE për kontratë citat i kësaj dispozite" 6.Një vendim i OSHP-së për ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënies së kontratës nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar".Nga veprimet e AK nuk gjejmë se ka një ri-vlerësim profesional dhe në pajhtim me LPP por gjejmë se të njejtit fare nuk kan bërë ri-vlerësim dhe rishqyrtim të kërkesësë tonë.

Ne si OE kemi pretenduar se DT gjatë ri-vlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit na eliminon nga ky aktivitet i prokurimit pas pranimit të vendimit të OSHP se kemi tejkaluar tolerancën e gabimeve aritmetikore të lejuar sipas LPP.
AK-Komuna e Prizrenit me rastin e zhvillimit të këtij aktivietit të prokuimit gjatë përgaditjes së DT përkatësish në paramasat dhe parallogari,gjatë ri-vlerësimit dhe ri-shqyrtimit ka dështuar në përgaditjen e tyre konform nevojave dhe natyrës së prokurimit publik dhe eliminimit të këtyre të metave me rastin e ri-shqyrtimit,ashtuqë ka bërë:.

-Vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe
-Shkelje esenciale të dispozitave të LPP-ës.

Arsyetimi i AK lidhur me refuzimin e kërkesës tonë për ri-shqyrtim është në kundërshtim me dispozitat e nenit 108A të LPP-së sepse nuk është sqaruar dhe nuk ka arsyeshmëri bindëse se përse refuzohet kërkesa jonë për ri-shqyrtim.
*Nga AK kemi këkuar qasje në DT të OE të rekomanduar për kontratë ku ky OE është i pa përgjegjshëm sepse në paramasën nr.32 dhe 46 nuk ka dhë fare qmim që bazuar në LPP OE nuk u lejohet që të mos plotësojnë pozicione të caktuara në paramasa dhe parallogari,nëse e shiqojmë i njejti në rubrikën 46 ka tentuar që të plotësoj kët pozicion por ka shënuar vetëm me **një vizë(-) dhe euro.***
Nga praktika e deritanishme Paneli shqyrtues i OSHP në rastet e ngjashme të cilat ka gjetur se paramasat dhe parallogait të një pozicioni nuk jan plotësuar nga OE i ka shpallur të pa përgjegjshëm dhe një rast i till dhe identik është me këtë aktiveitet të prokurimit sepse është evidente dhe e konfirmuar se kemi të bëjmë me pozicion të veqant për të cilin OE nuk e ka plotësuar pozicionin 32 dhe 46 e në veqanti në pozicionin 46 ka intervenu dhe ka –(vizë)që në prokurim publik nuk njifet dhe nuk pranohet.
Provë:Paramasa dhe parallogaria e OE të rekomanduar për kontratë.
Nga kjo vrehet qartë se DT dhe NJPK nuk është bërë konform nenit 27 dhe 28 të LPP.
Lidhur me qështjet tjera ne po e ri-përsërisim edhe njëher pretendimet tona ankimore të parashtruar në kërkesën për ri-vlerësim dhe atë;
Ne si OE nuk pajtohemi me kët arsyetim të AK me arstin e eliminimit tonë nga ky aktiviteti i prokurimit sepse është evidente që është bërë vërtetim i gabuar i gjendjes faktike me rastin e vlersimit dhe ri-shqyrtimit të ofertave dhe krahasimin e tyre sipas kërkesave dhe nevojave të AK dhe të cilat kanë qenë në kundërshtim me natyrën prokurimit publik.
Kjo vrehet edhe për faktin se me rastin e përgaditjesë së DT edhe për kundër vrejtjes sonë AK nuk ka ndërrmarr veprime që të bëjë përmirsimet në pozicionin e caktuar që ka të bëjë me pozicionin 39.
Ne si OE gjatë analizimit të këtij pozicioni nuk kemi mund që të japim qmim ku ky pozicion fare nuk ka të bëjë dhe nuk ka lidhmëri me pozicionet nga 34-48 dhe askund nuk nuk ka lidhmëri me to.

Po ashtu si ka mundësi që pozicioni 33 nuk është i përfshiorë në këtë kërkesë nga 34-48 sepse edhe pozicioni 33 ka të bëjë me furnizim dhe montim të gypave që për ne kjo është bërë me qëllim nga njësia kërkuese vetëm e vetëm që të të jenë konfuz dhe ti përgaditet OE të caktuar.

Nëse e shiqojm me vëmendje DT në veqanti paramasa tek pjesa C është konfuze pozicioni 32 është lënë zbraztirë që të ofrohet qmim dhe kalon në numrin rendor 33,34,35 etj etj, AK është i detyruar që të gjithë OE të cilët nuk kan dhën qmim për pozicionin 32 duhet të eliminohen sepse është pozicion në vete sikur pozicioni 33,34,35 etj deri tek pozicioni 38,ky defekt shifet qartë nëse bëjmë krahasimin me pozicionin 46 ku vrehet qartë dallimi,në këtë pozicion fare nuk kanë vazhduar me numër rendor përbrenda këtij pozicioni sikur tek 32 por i kan konsideru si një pozicion edhe për kundër që ka katër nën pozicione.

Pozicioni 39 që ka të bëjë me materiali ndihmës për acetilen,oksigjen,bërryla për elektroda,për mbajtëse të gypave etj si mund të llogaritet dhe në cilin pozicion mund të ketë lidhmëri dhe pse është përjashtuar pozicioni 33 nga përllogaritja.

Nuk ka lidhmëri dhe nuk ka mundësi tœ jepet qmim paushall pa e ditur se a ka nevoj apo jo.

Nëse shiqojm me kujdes dhe në aspektin profesional pozicioni 39 nuk përket me nevojat e e asnjë pozicioni tjeter perveq 32deri38, dhe nuk ka nevoj fare të llogaritet per pozicionet tjera,lidhur me këtë kërkojm nga OSHP që të caktoj një ekspert të lëmisë përkatse dhe profesional me qëllim të dhënies së një mendimi profesional për këtë pazicion se në cilat pozicione mund të përdoret acetileni,oksigjeni,brrylat për elektroda etj.

Eksperti shqyrtues dhe paneli shqyrtues duhet të krahasojn paramasat dhe parallogaria ***tek instalimet*** *me paramasat dhe parallogarit si psh.punët përgaditore,punët e muratimit,suvatimit,punët e llamarinës etj ku gjejmë se tabela e përgaditur është e qart dhe e kuptueshme sepse përshkrimi i punimeve,njësia ,sasia,qmimi dhe totali janë të ndara nga përmbajtja kurse tek instalimet na jep të kuptoj se jemi të obliguar që për pozicionin 32 dhe 46 të vendoset qmim në vete.*

AK dosjen e tenderit e ka përgadit në kundërshtim me dispozitat e nenit 27 dhe 28 të LPP me vetë faktin që pozicioni 32 është pozicion në vete prej atyre 33 deri në 38 edhe pozicioni 46 është pozicion në vete që OE kan qenë dashur ti plotësojnë sepse nuk janë të ndarë nga paramasa dhe parallogaria por janë identik sikur pozicionet tjera e që janë obligative të jepet qmim.

AK me rastin e rekomandimit për kontratë nuk ka marr parasysh kriterin për dhënie të kontratës edhe për kundër që është përcaktuar për kriterin tenderi i përgjegjshëm me qmim më të ulët duke e rekomanduar për kontratë OE i cili ka gabime dhe dështime në plotësimin e paramasave dhe parallogarisë ashtuqë ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 dhe 52 të LPP-së

AK me këtë ka vepruar në kundërshtim me nenin 7.6(v)dhe (vi) citat:" (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse."

Neni 59.4 poashtu e trajton dhe rregullon këtë qështje citat :" Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi nëfjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në

dosjen e tenderit....."

Po asht AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 1 të LPP citat" ***Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese,koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla"***

Shkelje të dispozitave të nenit 52 të LPP-së ***1. Autoriteti kontraktues në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit do të specifikoj kriteret që do të përdoren për dhënie të kontratës. Kriteret mund të jenë ose çmimi më i ulët ose tenderi ekonomikisht më i favorshëm në që rast ne kemi qmimin më të ulët dhe OE i përgjegjshëm .***

AK me rastin e ri-shqyrtim konform nenit 108A ka mundësin ashtu siq parashifet me këtë nen të evitoj gabimet që kan ndodh në fazën e vlerësimit dhe vendos konotrm LPP duke anuluar vendimin eliminim të aktivitetit të prikurimit dhe të na shpall të fitues për këtë aktivitet të prokurimit.
Andaj nga të cekurat më lartë kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese lidhur me aktivitetin e prokurimit:"Ndërtimi i objektit të ri shkollor Zef Lush Marku në Velezhë faza e tretë",numri i aktivitetit të prokurimit: 622-20-2647-521 të marr këtë:

VENDIM

1.Aprovohet si e bazuar ankesa e OE "EdiBau-ing"SHPK lidhur me aktiviteti i prokurimit për tenderin:"Ndërtimi i objektit të ri shkollor Zef Lush Marku në Velezhë faza e tretë",numri i aktivitetit të prokurimit: 622-20-2647-521

2.Anulohet njoftimi përdhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit: :"Ndërtimi i objektit të ri shkollor Zef Lush Marku në Velezhë faza e tretë",numri i aktivitetit të prokurimit: 622-20-2647-521 ***"dhe lënda kthehet në ri-vlerësim.***

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

Fakt 1: *Neni 56.15 në RRUOPP*

56.15 Kurdo qe Autoriteti kontraktues nuk dine sasitë indikative, ***kontratat me çmime për njësi***, AK duhet te përcaktoj peshët ne baze të rëndësisë se secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Ne këto raste nuk vlen pragu apo tavani **plus/minus tridhjetë përqind (30%), si p.sh. mirëmbajtje te veturave, mirëmbajtje te gjeneratorëve etj.** Ne këto raste ne hapje publike te ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qellim te vlerësimit te ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi. Shuma e sigurimit te ekzekutimit te kontratës ne këto raste duhet te përcaktohet si shume fikse ndërsa për qëllime te raportimit ne KRPP shënohet vlera e parashikuar e kontratës. Kontratat me çmime për njësi mund te udhëhiqen për te gjitha llojet e kontratave, kontratë për furnizime, shërbime dhe pune.

Fakt 2: *Materiali ndihmës ku vlera e së cilit llogaritet 30% prej vlerës nga pika 34-48, cmime këto me poentim tek pjesa C. Instalimet.*

	C. INSTALIMET				
32	Furnizimi dhe montimi i gypave të çelikut për ngrohje qendrore:				
33	DN 80	m'	18		
34	DN 50	m'	12		
35	DN 40	m'	18		
36	DN 32	m'	12		
37	DN 25	m'	18		
38	DN 20	m'	18		
39	Materiali ndihmës për acetilen, oksigjen, bërryla për elektroda, për mbajtësa të gypave etj. llogaritet 30 % prej vlerës nga pika 34-48	%	0.3		
	Furnizimi dhe montimi i ormaneve (kasetave) me dimensione 600 x 500 me kolektorë, me ventil sferik hyrës dhe kthyes DN 25 me 7 dalje dhe valvolë për ç'ajrosje automatike				

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

N/A

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Pas shqyrtimit në detaje të lëndës së tenderit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe duke u bazuar në dokumentacionin në dispozicion, eksperti shqyrtues jep këtë mendim si në vijim:

Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues ku thuhet që OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse në paramasën nr.32 dhe 46 nuk ka dhënë fare cmim që bazuar në LPP nuk lejohet që të mos plotësojnë pozicione të caktuara, Eksperti Shqyrtues pas shqyrtimit të dokumentacionit të tenderit, gjegjësisht paramasës dhe kërkesave të dosjes e gjen pretendimin e lartpërmendur si të pabazuar. Arsyetimi i një konstatimi të tillë vijon si më poshtë:

- Paramasa e ngarkuar nga Autoriteti Kontraktues, gjegjësisht pozicionet 32 dhe 46 janë dizajnuar të shënohen si nëntituj. Do të thotë, pozicioni 32 tek Pjesa C. Instalimet, shënon: "Furnizimi dhe montimi i gypave të celikut për ngrohje qëndrore:" duke listuar kështu llojet e gypave të përmendur në pozicionet e radhës (33, 34, 35, 36, etj). E njëjta logjikë e dekompozimit të materialeve të kërkuara përdoret edhe tek pozicioni 46, pjesa C Instalimet ku shënon "Radiatora të çelikut të "Fabrikës së radiatorave" Gjilan ose te ngjajshem , porositen komplet me mbajtësa, valvolave për ajrosje dhe kapakë horizontal dhe vertikal.", ndërsa tipet e produkteve të lartpërmendura listohen si nënpozicione.

46	Radiatora të çelikut të "Fabrikës së radiatorave" Gjilan ose te ngjajshem , porositen komplet me mbajtësa, valvolave për ajrosje dhe kapakë horizontal dhe vertikal.				
	Tip 22-500x1000	cope	2		
	Tip 22-500x1500	cope	2		
	Tip 22-500x2000	cope	7		
	Tip LUX 500x1000	cope	15		

- As pozicioni 32 as 46 nuk kanë të shënuara njësi të matjes në shabllonin e paramasës së dizajnuar nga Autoriteti Kontraktues, karakteristikë kjo e cila nënkupton që pozicionet e tilla shërbejnë nën cilësine e përmendur më lartë dhe ndihmojnë në dekompozimin e produkteve të kërkuara.
- Vlen të ceket që pozicionet e tilla nuk janë plotësuar në paramasat e tyre të ofertuara as nga OE ankues dhe as nga ai i rekomanduar për kontratë, konform kërkesave dhe përshkrimit të paramasës, dhe si të tilla, mos plotësimi i pozicioneve të lartpërmendura nuk thërret në shpalljen e papërgjegjshme të operatorëve ekonomik pasi që për rastin konkret nuk kemi shkelje të nenit 52 dhe 59 të LPP-së.

Sa i përket pretendimit ankimor në lidhje me përllogaritjen e saktë të pozicionit me numër 39, Eksperti Shqyrtues konstaton që një cështje e tillë është tashmë e gjykuar – res judicata – në raportin me numër rendor të ankesës 548/20 të datës 04.09.2020. Po ashtu, natyra teknike e pozicionit në fjalë, gjegjësisht përfshirja e llogaritjes së pozicionit si përqindje e vlerës së pozicioneve 34-48 dhe arsyeshmëria teknike e kësaj përfshirjeje dhe jo e materialeve të tjera ndihmëse mbetet nën diskrecion të Autoritetit Kontraktues, respektivisht njësisë kërkuese që të plotësojë dosjen konform nenit 27 të LPP-së.

Duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, kronologjinë e rastit në fjalë dhe natyrën e pretendimeve, Eksperti shqyrtues e sheh ankesën e operatorit ekonomik ankues si të pabazuar, duke sugjeruar kështu që njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i objektit të ri shkollor Zef Lush Marku në Velezhë faza e tretë" me nr. të prokurimit: "622-20-2647-5-2-1", aktivitet ky i iniciuar nga AK: KK Prizren, të mbetet në fuqi. Një sugjerim i tillë vjen si rezultat i konstatimeve të pretendimeve.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues duhet të jetë: e pabazuar dhe të vërtetohet vendimi i AK-së.

Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues **KK Prizren**
- Panelit Shqyrtues **OSHP**
- OE ankues **Edibau-ing SHPK - Prizren**